

SHQIPËRIA

MËSIMET

NGA MENAXHIMI I PANDEMISË PËR NJË TË ARDHME MË TË SIGURT

Romario Shehu



MËSIMET

NGA MENAXHIMI I PANDEMISË PËR NJË TË ARDHME MË TË SIGURT SHQIPËRIA

Botues:

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H. 1, Tirana, Albania
www.idmalbania.org, info@idmalbania.org

Autor:

Romario Shehu

Dizajni:

Srđan Ilić

Mars 2023



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

Ky raport u bë i mundur me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet janë të autorit dhe nuk shprehin apo pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF-së.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Ky studim shqyrton mënyrën e menaxhimit të pandemisë COVID-19 në Shqipëri. Ai shqyrton në veçanti kapacitetet shëndetësore dhe reagimin e qeverisë shqiptare, aspektet gjeopolitike të pandemisë dhe rolin e organizatave dhe mekanizmave ndërkombëtare për menaxhimin e saj. Analiza në këtë raport mbështetet tek burimet parësore dhe dytësore të informacionit. Të dhënat parësore janë marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Statistikave nëpërmjet kërkesave për informacion, në rastin kur të dhënat nuk ishin të disponueshme për publikun të gjerë. Burimet dytësore përfshijnë statistikat zyrtare, studimet dhe hulumtimet rreth COVID-19 nga institucionet qeveritare, raportet kërkimore dhe publikimet në media.

COVID-19 është një sëmundje e rrugëve të frymëmarrjes që u zbulua në dhjetor 2019 dhe ka shkaktuar krizë shëndetësore dhe ekonomike, duke sjellë pengesa dhe probleme të rënda. Vendet në mbarë botën kanë marrë masa për ta trajtuar këtë kërcënim, përfshirë dhe shpalljen e gjendjes së pandemisë, mbylljen e kufijve, vendosjen e izolimit ose kufizimeve të lëvizjes si dhe pezullimin e shumicës së aktiviteteve. Që nga dhjetori 2020, në mbarë botën janë zhvilluar dhe administruar lloje të ndryshme vaksinash kundër COVID-19.¹ Pandemia COVID-19 ende nuk ka përfunduar dhe nuk mund të përjashtohet mundësia e valëve të reja. Megjithatë, shumica e vendeve i kanë hequr kufizimet e pandemisë, pasi perceptimi i rrezikut shëndetësor nga virusi ka ndryshuar, veçanërisht për popullatën e vaksinuar. Pandemia pati një ndikim tronditës tek shoqëritë tona, duke marrë jetë njerëzore² dhe duke i shtuar sfidat ekonomike, politike, shëndetësore dhe sociale në rang global.³

Rastet e para me COVID-19 në Shqipëri u regjistruan në mars të vitit 2020. Ashtu si vendet e tjera në botë, edhe Shqipëria mori masa të menjëhershme për t'iu përgjigjur kërcënimit, ku përfshihej shpallja e gjendjes së pandemisë dhe, më pas, e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vend, mbyllja e kufijve, izolimi i popullsisë, kufizimi i lëvizjes dhe pezullimi i shumicës së aktiviteteve në vend. Këto masa vazhduan pjesërisht deri në qershor 2020 kur u hoqën shumica e kufizimeve, dhe më pas u hapën të gjithë kufijtë me vendet fqinje.⁴ Vendi filloi vaksinimin kundër COVID-19 më 11 janar 2021.⁵ Në periudhën 2020-2022, në Shqipëri u regjistruan gjithsej 332.941 raste infektimi dhe 3.596 vdekje nga COVID-19.⁶

Pasi u godit rëndë nga tërmeti i vitit 2019, **ekonomia** në vështirësi e Shqipërisë u dobësua më tej nga pandemia. Raporti i Rregullt Ekonomik i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor vinte në dukje se Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) u tkurr me 4%^[7] në 2020 – edhe pse më pak se sa pritej fillimisht – qeveria shtoi borxhin publik për të zbutur humbjet ekonomike nëpërmjet rritjes së shpenzimeve. Pas tkurrjes në vitin 2020, në vitin 2021 pasoi një rimëkëmbje ekonomike më e fortë se sa pritej, e cila e çoi rritjen reale të PBB-së në 8.3%.⁸ Shkalla e papunësisë ka mbetur e njëjtë që nga viti 2019, me përjashtim të një rritjeje të lehtë në vitin 2020.


Në Shqipëri ka një rënie të jetëgjatësisë që sa vjen e shtohet (shih tabelën 1), e cila përkon me afatin kohor të COVID-19 në vend. Numri i përgjithshëm i banorëve në Shqipëri ka qenë në rënie të vazhdueshme që nga viti 2019, ndërsa numri i vdekjeve ka ardhur në rritje. Në 2020, kishte 5,668 vdekje më shumë krahasuar me 2019-n, dhe në 2021, 8,643 vdekje më shumë krahasuar me 2019-n. Nëse këto shifra zbriten nga numri i përgjithshëm i vdekjeve të regjistruara nga COVID-19 në 2020 dhe 2021, mbeten 11,094 më shumë vdekje në 2020 dhe 2021 krahasuar me 2019-n. Disa raporte⁹ sugjerojnë se vdekjet e tepërta janë të lidhura me pasojat e COVID-19, ndonëse nuk janë regjistruar si të tilla.

| SHQIPËRIA | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Popullsia | 2,862,427 | 2,845,955 | 2,829,741 | 2,793,592 |
| Jetëgjatësia | 79,1 | 77,4 | 76,5 | - |
| Vdekjet gjithsej | 21,937 | 27,605 | 30,580 | - |
| Vdekjet nga COVID-19 | - | 1,181 | 2,036 | 379 |
| Shtretër spitalorë | 8,189 | 8,334 | 8,501 | - |
| Papunësia (15-64 vjeç) | 12% | 12,2% | 12% | - |

Tabela 1: Të dhënat janë siguruar nga faqja në internet dhe nga kërkesat për informacion drejtuar Institutit të Statistikave si dhe nga faqja Coronavirus.al

Grafiku 1 tregon **numrin e përgjithshëm të vdekjeve nga COVID-19 dhe rastet e reja të infektimit në vend**. Dimri i 2020/21-shit, pranvera e 2021-shit dhe vjeshta e 2021-shit, janë stinët kur COVID-19 shkaktoi numrin më të lartë të vdekjeve në vend. Marsi i 2021-shit (425), shkurti i 2021-shit (423), dhjetori i 2020-s (364) dhe nëntori i 2020-s (304) ishin muajt kur COVID-19 mori shumë jetë në vend. Nga ana tjetër, vjeshta (përfshirë dhjetorin) e 2022-shit, pranvera e 2022-shit dhe pranvera e 2020-shit, ishin stinët me numrin më të ulët të vdekjeve nga COVID-19 në Shqipëri. Për sa u përket

muajve korriku i 2021-shit, maji i 2022-shit, nëntori i 2022-shit, me nga një vdekje dhe maji i 2020-s dhe dhjetori i 2022-shit, me nga dy vdekje, ishin muajt me numrin më të ulët të vdekjeve nga COVID-19 në Shqipëri. Për rastet e reja me COVID-19, dimri i 2021/22-shit, dimri i 2020/21-shit, vjeshta e 2021-shit dhe vera e 2022-shit, ishin stinët me numrin më të madh të rasteve të reja me COVID-19. Për sa u përket muajve, janari i 2022-shit (48.319), korriku i 2022-shit (31.619), shkurti i 2021-shit (29.040) dhe shtatori i 2021-shit (24.198), ishin muajt me numrin më të madh të rasteve të reja me COVID-19. Nga ana tjetër, pranvera e 2020-s, vjeshta (përfshirë dhjetorin) e 2022-shit, pranvera e 2022-shit dhe vera e 2020-s, ishin stinët me numrin më të ulët të rasteve të reja me COVID-19, ndërsa muajt me më pak infeksione ishin qershori i 2021-shit (206), marsi i 2020-s (243) dhe maji i 2020-s (364).



Grafiku 1: Burimi: Cronavirus.al

I renditur në vendin e 74-të (nga 89) në listën e vendeve me sistemet më të mira të kujdesit shëndetësor në vitin 2021,¹⁰ **sistemi shëndetësor i Shqipërisë** u gjend në vështirësi në përballje me pandeminë COVID-19. Për sa i përket disponueshmërisë së maskave dhe testeve në fillim të pandemisë, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) raporton se në korrik të 2020-s Shqipëria kishte 90,000 teste dhe kishte testuar më shumë se 30,000 persona deri në atë kohë.¹¹ Në fillim të pandemisë pati mungesë maskash, pjesërisht e shkaktuar nga blerja në panik e maskave nga qytetarët. Situata u stabilizua më vonë, në prill, kur Shqipëria siguroi pajisje mbrojtëse personale për personelin mjekësor, që e përmirësonin sigurinë e mjekëve dhe infermierëve në përballjen me COVID-19.¹²

COVID-19 pati një efekt anësor pozitiv, pasi nxiti më shumë investime për përmirësimin e objekteve të kujdesit shëndetësor në vend. Numri i shtretërve spitalorë *për frymë* në Shqipëri (shih tabelën 1) pësoi rritje, nga 2.86 shtretër për 1000 banorë në 2019, në 2.92 në 2020 dhe 3.0 në 2021. Numri i respiratorëve në Shqipëri para pandemisë ishte rreth 200,¹³ ndërsa në periudhën në vijim, numri i respiratorëve në spitale u rrit me rreth 2.5 herë, duke shkuar mbi 500 pajisje.¹⁴ Institucionet shëndetësore publike punësuan 61 epidemiologë, 128 ndihmës epidemiologë dhe 124 anesteziologë¹⁵ gjatë trajtimit të pandemisë.

Më 26 shkurt 2020, qeveria shqiptare ndryshoi ligjin për **prokurimin publik**,¹⁶ duke i lejuar institucionet publike t'i kontraktin kompanitë pa tender publik, kur ato kompani ishin në gjendje t'i ofronin shërbimet dhe mallrat e kërkuara në rast nevojë urgjente. Kjo përfshinte situata si pandemia, "të shkaktuara nga rrethana të jashtëzakonshme, jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor" dhe kur "koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera." Që nga shpallja e këtij vendimi deri më qershor të vitit 2021, nga institucionet shëndetësore janë prokuruar gjithsej 214 kontrata, prej të cilave janë realizuar 193.¹⁷ Sipas një monitorimi të pavarur, 89% e vlerës së parashikuar të prokurimit të furnizimeve për COVID-19 të ndërmarra nga autoritetet shqiptare është shpërndarë nëpërmjet procedurave të prokurimit me rrezik, duke nxjerrë në pah probleme që lidhen me respektimin e konkurrencës.¹⁸ Gjatë kësaj periudhe, qeveria shqiptare nënshkroi 15 kontrata sekrete në lidhje me COVID-19 (pa procedurë të hapur konkurruese) me vlerë rreth 37.6 milionë euro.¹⁹ Vendimi për shpalljen e të gjitha kontratave si "interesa thelbësore të shtetit" shkaktoi paralajmërime për keqpërdorim të mundshëm të fondeve shtetërore, favorizime, dyshime për korrupsion dhe shkelje të interesave publike.²⁰ Për më tepër, edhe kontratat e furnizimit me vakcina, të nënshkruara nga qeveria shqiptare me kompani të ndryshme farmaceutike, konsideroheshin sekret shtetëror dhe disa deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që i votuan këto kontrata nëpërmjet ligjeve të posaçme, pretenduan se u ishte dhënë informacion minimal përpara se të votonin.²¹ Kur pandemia ishte në kulmin e saj, Shqipëria përfundoi katër marrëveshje për furnizimin e vaksinave kundër COVID-19 . Këto kontrata janë klasifikuar si konfidenciale, prandaj detajet e këtyre kontratave nuk dihen. Për sa u përket kostove të tyre, të dhënat e raportit të vitit 2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë²² tregojnë se shumica e përgjithshme e fondeve të shpenzuara për blerjen e vaksinave në vitin 2021 ishte 3.4 miliardë lekë (29.6 milionë euro).

Vaksinimi kundër COVID-19 në Shqipëri filluoi më 11 janar 2021 dhe deri në dhjetor 2022 u administruan gjithsej 3,029,614 doza vaksinash, nga të cilat 1,327,179 doza të para, 1,273,485 doza të dyta dhe 386,011 doza të treta. Shqipëria ka administruar vaksinate mëposhtme kundër COVID-19 : Comirnaty (Pfizer–BioNTech), Vaxzevria-AstraZeneca, Covishield–AstraZeneca, CoronaVac–Sinovac dhe Gam-COVID-Vac-Sputnik V.²⁴ Shqipëria ishte ndër vendet e përfshira në COVAX, e cila është një nismë mbarëbotërore që synon akses të barabartë tek vaksinat e COVID-19 .²⁵ Që nga viti 2021, thuhet se Shqipërisë i janë dorëzuar 331,800 doza , nëpërmjet nismës COVAX, nga të cilat 188,400 ishin dhurime.²⁶ E pyetur për sasinë e vaksinave të dhuruara për Shqipërinë nga çdo vend dhurues, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u përgjigj se Shqipëria ka marrë 947 880 vakcina kundër COVID-19 si dhurime nga Bashkimi Evropian (BE), Portugalia, Greqia, Kroacia, Suedia, Letonia, si dhe nga Emiratet e Bashkuara Arabe,²⁷ pa përmendur numrat specifikë të dozave të vaksinave të dhuruara nga secili vend.

Megjithëse Shqipëria ishte kryesisht në pozicionin e marrësit të ndihmës së huaj, ajo nuk i la mënjane **përpjekjet e saj për diplomaci gjatë COVID-19**, pasi u përpoq të mbështeste vendet e tjera duke dërguar punonjës të kujdesit shëndetësor dhe duke administruar vakcina për punonjësit e vijës së parë të vendeve fqinje. Më herët, Shqipëria vendosi të dhurojë vakcina në Kosovë për shkak të vështirësisë së Kosovës për

sigurimin e vaksinave. Kosova nuk njihet nga dy shtetet kryesore prodhuese të vaksinave (Kina dhe Rusia), kështu që mund të merrte vetëm vaksinat e prodhuara në Shtetet e Bashkuara ose në Mbretërinë e Bashkuar, të cilat në atë kohë ishin shumë të kërkuara. Në këtë kontekst, Shqipëria ofroi ndihmë për vaksinimin e personelit të vijës së parë në Kosovë duke demonstruar afërsinë midis dy vendeve dhe potencialisht përpjekjen për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe në nivel qeveritar pas disa mosmarrëveshjeve jo shumë të rëndësishme.²⁸ Në Shqipëri u vaksinua një pjesë e punonjësve të sistemit shëndetësor të Republikës së Kosovës.²⁹ Edhe pse në përgjigjen zyrtare Ministria nuk e saktësonte numrin e vaksinave për punonjësit e shëndetësisë në Kosovë, shkrimet në media tregojnë se për ta janë përdorur rreth 500 vakcina.³⁰ Shqipëria ofroi, gjithashtu, vakcina për mësuesit e Kosovës. Megjithatë, vakcina që Shqipëria ishte në gjendje të ofronte në atë kohë ishte Sinovac i Kinës, dhe Qeveria e Kosovës e refuzoi ofertën me argumentin se Kosova do të pranonte vetëm vaksinat që prodhoheshin në vendet që e njihnin Republikën e Kosovës.³¹ Në mars 2020, 30 mjekë dhe infermierë nga Shqipëria u dërguan në Itali, pasi vendi po kalonte vështirësi në përballimin e urgjencave spitalore.³²

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, së bashku me institucionet në varësi të saj, **kishin rolin kryesor për informimin e publikut për menaxhimin e pandemisë.**³³ Përfaqësuesit e këtyre institucioneve mbanin konferenca të përditshme për shtyp për të informuar publikun për ecurinë e situatës.³⁴ Në anën tjetër, gazetarët nuk kishin kufizime të lëvizjes, si shumica e qytetarëve, dhe kishin mundësi t'ia komunikonin publikut të gjitha lajmet përkatëse për pandeminë. Megjithatë, gjatë mbylljes së plotë të vendit, gazetarët nuk mund t'i ndiqnin konferencat për shtyp, gjë që çoi në rritjen e përdorimit të mediave sociale nga autoritetet përgjegjëse për përballimin e pandemisë, për përhapjen e informacionit shëndetësor tek publiku.³⁵ Kjo shkaktoi përkeqësim të lirisë së shtypit dhe ndikoi në mënyrën se si e perceptonin qytetarët menaxhimin e pandemisë. Si çdo vend tjetër, edhe Shqipëria u prek nga teoritë konspirative për pandeminë, teori që mbivendoseshin dhe, shpesh, ishin kontradiktore. Në fazën e hershme, lajmet e rreme varionin nga portretizimi i pandemisë si gënjeshtër, ekzagjerim, apo edhe si një armë biologjike e një 'mafieje globale', e deri tek ofrimi i 'kurimeve natyrore' për shërimin nga virusi dhe forcimin e sistemit imunitar.³⁶ Me fillimin e procesit të vaksinimit, dezinformimi u zhvendos tek konspiracionet kundër vaksinave, duke vënë në dyshim vlerën e tyre ose duke lënë të kuptohet se ato kishin pasoja negative në trupin e njeriut.³⁷ Shqetësuese për Shqipërinë në këtë drejtim është se konspiracione të tilla u promovuan edhe në kanalet televizive të njohura,³⁸ përveç mediave sociale dhe portaleve në internet. Institucionet shëndetësore shqiptare zhvilluan një sistem për ta menaxhuar "pandeminë e dezinformimit" duke identifikuar dhe trajtuar lajmet e rreme që u përhapën për të krijuar panik në publik.³⁹ Edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) organizoi dy trajnime për 'Menaxhimin e infodemisë' për të trajtuar thashethemet dhe dezinformimin në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe vaksinimin në Shqipëri.⁴⁰ Megjithatë, trajnimet patën ndikim të kufizuar, duke qenë se Shqipëria vlerësohet si vendi me numrin më të madh të mbështetësve të teorisë konspirative për COVID-19 në Ballkanin Perëndimor.⁴¹ Për më tepër, më shumë se gjysma e shqiptarëve nuk kanë besim tek institucionet e kujdesit shëndetësor në vend. Niveli i besimit tek institucionet shëndetësore në

Shqipëri pësoi një rënie të lehtë në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë,⁴² duke e perceptuar shëndetësinë si institucionin e dytë më të korruptuar në vend në vitin 2020.⁴³ Mungesa e pjesëmarrjes së gazetarëve në konferencat për shtyp, publikimi i pakufizuar i teorive të panumërta konspirative në mediat sociale dhe portalet në internet, promovimi i konspiracioneve në kanalet e njohura televizive, besimi i ulët tek institucionet e kujdesit shëndetësor, së bashku me kontratat e dyshimta të qeverisë⁴⁴ si dhe niveli i ulët i transparencës qeveritare gjatë pandemisë, mund të kenë prodhuar një terren pjellor në vend për teoritë konspirative.

Shqipëria ndërmori masa të ashpra mbylljeje për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Këtu përfshiheshin kufizimi i përkohshëm i lëvizjes, gjobat administrative për shkelje të kufizimit, karantinimi dhe kriminalizimi i shkeljes së karantinës dhe infektimit të qëllimshëm, si dhe përdorimi i forcave policore dhe ushtarake për t'i zbatuar masat.⁴⁵ Pandemia vuri në pah **brishtësinë e demokracisë në vend**. E drejta për të protestuar u pezullua dhe lëvizja u kufizua ndjeshëm. Shumica e masave shtetërore u përqendruan dhe u vendosën nga Kryeministri nëpërmjet akteve normative, pa miratimin e Kuvendit dhe pa konsultime publike.⁴⁶ Rënia e besimit të publikut tek aftësia e qeverisë për ta trajtuar pandeminë ishte e dukshme kur qytetarët dhe shoqëria civile u mblohdën në mënyrë të përsëritur për të kundërshtuar masat qeveritare kundër pandemisë – duke përfshirë ndryshimet në Kodin Penal, përdorimin e detyrueshëm të maskave dhe vaksinimit e supozuar të detyrueshëm – në verën dhe vjeshtën e vitit 2020.⁴⁷ Në një deklaratë të përbashkët të OSHC-ve, theksohej se dënimet e propozuara në Kodin Penal për shkeljen e masave për parandalimin e përhapjes së virusit cenojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve.⁴⁸ Më 8 dhjetor 2020, një oficer policie vrau një njëzetepesëvjeçar në Tiranë për shkelje të aktit normativ të ndalimit të lëvizjes. Edhe pse oficeri i policisë u arrestua dhe u akuzua për vrasje me dashje, reagimi publik ishte i madh. Në Tiranë dhe qytete të tjera, u zhvilluan disa protesta të dhunshme dhe jo të dhunshme, të cilat çuan në dorëheqjen e ministrit të Brendshëm.⁴⁹ Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme lidhur me pandeminë COVID-19 në vitin 2021, Avokati i Popullit ngriti shqetësime për pjesëmarrjen demokratike, lirinë e lëvizjes dhe tubimit, kufizimet e së drejtës së jetës familjare dhe privatësisë dhe promovoi në mënyrë proaktive parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në legjislacionin për pandeminë.⁵⁰ Në Shqipëri nuk ka pasur zgjedhje në asnjë nivel gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë. Zgjedhjet e përgjithshme u zhvilluan më 25 prill 2021, kur vetëm një numër i vogël kufizimesh për pandeminë ishin në fuqi. Në përgjithësi, masat parandaluese kundër COVID-19 nuk u zbatuan mjaftueshëm gjatë procesit të votimit, dhe distanca sociale nuk u respektua gjithmonë.⁵¹ Statusi i demokracisë në vend pati një rënie shumë të lehtë në vitin 2020, pasi Shqipëria shënoi 67/100 në Vlerësimin Global të Lirisë në vitin 2019,⁵² ndërsa në vitin 2020, vendi shënoi 66/100.⁵³

Mbështetja e organizatave ndërkombëtare për Shqipërinë lidhur me trajtimin e COVID-19 u sigurua nga Kombet e Bashkuara, kryesisht nëpërmjet Zyrës së OBSH-së në Shqipëri,⁵⁴ duke ofruar mbështetje në shumë drejtime, përfshirë: (i) drejtimin, koordinimin, planifikimin, financimin dhe monitorimin e situatës pandemike; (ii) komunikimin e rrezikut, angazhimin e komunitetit dhe menaxhimin e infodemisë; (iii) mbështetjen logjistike për ekipet e vëzhgimit dhe hetimit të vatrave të reja; (iv)

mbështetjen për vlerësimin e nevojave prioritare në pikat e hyrjes, udhëtimin, transportin dhe grumbullimin; (v) mbështetjen për vlerësimin e kapaciteteve diagnostikuese të laboratorëve dhe mjeteve diagnostike në spitale; (vi) vlerësimin e nevojave për trajnim për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve (PKI), dhe trajnimin e më shumë se 20,000 punonjësve shëndetësorë dhe vullnetarëve; (vii) OBSH-ja mbështeti shërbimet operacionale dhe logjistike për prokurimin e mjeteve diagnostikuese për COVID-19, menaxhimin e rasteve PKI, pajisjeve laboratorike, kompleteve, reagentëve, materialeve, pajisjeve IT, vaksinave, pajisjeve të zinxhirit ftohës, automjeteve, pajisjeve mbrojtëse personale dhe testeve të shpejta Ag për COVID-19-n; (viii) mbështetjen për forcimin e shërbimeve dhe sistemeve thelbësore shëndetësore; dhe (ix) lehtësimin e vaksinimit nëpërmjet mbështetjes teknike të ofruar për Grupin Kombëtar Këshillues Teknik të Imunizimit. Në ndihmë të Shqipërisë në luftën kundër pandemisë erdhi edhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Shqipëri. Që nga fillimi, UNDP-ja kontribuoi për reagimin e menjëhershëm duke rritur ndërgjegjësimin për rreziqet dhe parandalimin e COVID-19, si dhe nëpërmjet ofrimit të pajisjeve mjekësore dhe mbrojtëse dhe ngritjes së kapaciteteve për nëpunësit civilë dhe specialistët e tjerë për ta kaluar punën e tyre online, pa i ndërprerë shërbimet për njerëzit më në nevojë.⁵⁵ Si pjesë e asistencës afatgjatë, UNDP-ja mbështeti edhe analizën e performancës së tregut të punës dhe vlerësimin e ndikimit negativ të pandemisë në ekonomi, si dhe ndihmoi për hartimin e masave aktive të tregut të punës që synonin punësimin e shpejtë të fuqisë punëtore të pushuar për shkak të pandemisë.⁵⁶ BE-ja ka dhënë ndihmën më të madhe për Shqipërinë për trajtimin e pandemisë COVID-19. Komisioni Evropian ridrejtoi 50,65 milionë euro në grante për Shqipërinë për plotësimin e nevojave më të ngutshme dhe zhvillimin e politikave shoqërore dhe ekonomike ndaj pandemisë.⁵⁷ Komisioni ofroi gjithashtu asistencë makro-financiare prej 180 milionë eurosh nëpërmjet një kredie të butë që, pas përmbushjes së kushteve nga ana e Shqipërisë u disbursua plotësisht në vitin 2021. Shqipëria mori edhe 11,2 milionë euro grante nga Instrumenti i Asistencës së Par-Adherit (IPA) II për Partnerët e Ballkanit Perëndimor për rimbursimin e shteteve për dozat e blera në bazë të Marrëveshjeve të Blerjes Paraprake të BE-së me prodhuesit e vaksinave COVID-19 ose nëpërmjet porosive dypalëshe të vaksinave të njohura nga EMA.[59] Vlen të theksohet se, pavarësisht nga gjithë ndihma që përfitoi Shqipëria pas pandemisë, fillimi i COVID-19 u shoqërua me paqartësi që i shtynë shtetet të kujdeseshin për veten e tyre. Në këto kushte, Komisioni Evropian miratoi një rregullore (e vlefshme nga marsi deri në prill 2020) që ndalonte eksportimin e pajisjeve mbrojtëse personale dhe pajisjeve mjekësore në vendet e tjera.⁶⁰ Kjo qasje 'egoiste' nuk u prit mirë nga kryeministri shqiptar, i cili i cilësoi veprimet e BE-së si një "gabim të turpshëm" sepse "mendonin vetëm për veten e tyre", ndërsa vlerësoi Turqinë që i ofroi Shqipërisë mundësinë e blerjes së vaksinave dhe dërgoi një ngarkesë me furnizime mjekësore në një kohë kur nevojat ishin tepër të mëdha.^[61] Një sondazh i kryer në shtator 2021 zbuloi se 39.2% e shqiptarëve besonin se Turqia i kishte dhënë mbështetjen më të madhe financiare/humanitare Shqipërisë për përballjen me pandeminë COVID-19.

^[62] Ndonëse Bashkimi Evropian i dha Shqipërisë pjesën më të madhe të ndihmës gjatë pandemisë, përfshirë dhurimin e vaksinave, kritikën e kryeministrit Rama kundër BE-së dhe perceptimi publik linin të kuptojë se, në kohë nevojë, Ballkani Perëndimor mund të binte pre e ndikimit të huaj, në rast mospërgjigjeje nga BE-ja.

Që nga koha kur COVID-19 u regjistrua për herë të parë në Shqipëri, ka pasur një rënie të ndjeshme të jetëgjatësisë në vend. Nga njëra anë, numri i përgjithshëm i banorëve në Shqipëri ka qenë në rënie të vazhdueshme që nga viti 2019, në anën tjetër, numri i vdekjeve ka ardhur duke u rritur. Është e rëndësishme që autoritetet e shëndetit publik në vend të shqyrtojnë faktorët që kontribuojnë për vdekshmërinë e lartë.

Prokurimet publike gjatë pandemisë COVID-19 kanë pasur mungesë transparence. Praktikrat e 'kontratave sekrete' dhe lejimi kontraktimit të kompanive pa tender publik nga institucionet publike mund të perceptohen si keqpërdorim i fondeve shtetërore, favore për miqtë, dyshime për korrupsion dhe shkelje të interesave publike. Këto praktika e gërryejnë besimin e publikut tek institucionet dhe e dëmtojnë qeverisjen e mirë dhe demokracinë në vend. Si e tillë, është e rëndësishme që qeveria t'i shmangë këto praktika sa të jetë e mundur, ose, të paktën, të ruajë një komunikim proaktiv dhe transparent me publikun.

Si vendi me numrin më të madh të mbështetësve të teorive konspirative të COVID-19 në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria duhet ta trajtojë çështjen e dezinformimit në kuadrin e një qasjeje të koordinuar me të gjithë aktorët përkatës. Transparenca e institucioneve shtetërore dhe komunikimi i tyre publik kanë rëndësi të madhe për të siguruar besimin e publikut. Kanalet dhe faqet kryesore mediatike duhet të miratojnë rregulla më të rrepta kundër promovimit të konspiracioneve. Aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile duhet të përfshihen në fushatat kundër dezinformimit, duke rritur ndërgjegjësimin, duke ndërtuar kapacitete dhe programe për edukimin mediatik dhe duke mbështetur gazetarinë e pavarur dhe organizatat që verifikojnë faktet, për të bërë të mundur që informacioni i përhapur të jetë i saktë.

Masat e marra nga qeveria për ndalimin e përhapjes së COVID-19, duhet të përshtaten me nivelin e kërcënimit, t'i shpjegohen plotësisht publikut, pa anashkaluar konsultimet publike dhe pa cenuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve, përveçse kur bazohen te legjislacioni i vendit dhe merren nga autoritetet shtetërore përkatëse.

Ndonëse është e kuptueshme që BE-ja do të duhet t'u japë përparësi nevojave të veta në kohë krize, pamundësia për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor ose rajone të tjera mund të krijojë perceptimin se BE-ja nuk është partner i besueshëm dhe mund t'u lërë hapësirë aktorëve të jashtëm për ta forcuar ndikimin e tyre në këto vende. Prandaj, BE-ja duhet të shqyrtojë me kujdes pasojat e mundshme të pezullimit të mbështetjes për vendet e tjera në kohë nevojë, veçanërisht në rajone të tilla si Ballkani Perëndimor, dhe të vazhdojë t'i japë përparësi solidaritetit dhe bashkëpunimit global për përgjigjen ndaj krizave globale.

Shtojca 1

| Periudha kohore e masave të marra nga Shqipëria për trajtimin e pandemisë COVID-19 në vend (Pranverë 2020 – Dimër 2020/21) | |
|---|--|
| 8 Mars 2020 | (i) Pezullimi i eksportit të ilaçeve dhe pajisjeve mjekësore në vende të tjera; (ii) Ndalimi i aktiviteteve publike dhe jopublike dhe ndalimi i tubimeve masive në hapësira të mbyllura ose të hapura; |
| 9 Mars 2020 | (i) Regjistrohet rasti i parë i koronavirusit; (ii) Mbyllja e të gjitha institucioneve arsimore; |
| 10 Mars 2020 | (i) Pezullimi i të gjitha fluturimeve drejt/nga Italia; |
| 11 Mars 2020 | (i) Shpallet zyrtarisht gjendja e pandemisë në vend. Shqipëria bëhet vendi i parë në rajon që vendos masa të pjesshme bllokimi; (ii) Ndalimi i tubimeve masive dhe mbyllja e vendeve publike për aktivitete argëtuese; (iii) Kufizimi i kontakteve në institucionet publike dhe jopublike; (iv) Bëhet e detyrueshme karantina dyjavore për udhëtarët që vijnë në Shqipëri nga shtetet në zonën e kuqe të COVID-19. |
| 12 Mars 2020 | (i) Mbyllja e bareve, restoranteve, hoteleve. Ky urdhër zgjati deri më 15 maj 2020. |
| 14 Mars 2020 | (i) Mbyllja e të gjithë kufijve tokësorë me/nga Shqipëria; (ii) Pezullimi i të gjitha fluturimeve për/nga Greqia; |
| 15 Mars 2020 | (i) Kufizimi i lëvizjes brenda vendit |
| 16 Mars 2020 | (i) (Pezullimi i të gjitha fluturimeve ajrore për/nga Britania e Madhe; (ii) Kufizimi i lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane brenda vendit pas orës 18:00; |
| 18 Mars 2020 | (i) Kufizimi i lëvizjes së këmbësorëve në zonat urbane, i lejuar vetëm nga ora 06:00 – 10:00 dhe nga ora 16:00 – 18:00; |
| 24 Mars 2020 | (i) Shpallet në vend gjendja e fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë COVID-19 |
| 18 Maj 2020 | (i) Shqipëria heq masat e bllokimit. Lejohen të gjitha aktivitetet publike dhe ekonomike, përveç transportit publik, aktiviteteve sportive, shkollave dhe tubimeve masive; |
| 1 Qershor 2020 | (i) Shqipëria hap kufijtë për vendet fqinje; (ii) Hiqen të gjitha kufizimet e lirisë së lëvizjes në të gjithë vendin dhe gjatë gjithë kohës |
| 13 Tetor 2020 | 9i) Maskat bëhen të detyrueshme jashtë shtëpisë; |
| 9 Nëntor 2020 | (i) Kufizimi i aktivitetit të bareve, restoranteve, hoteleve, lejohet vetëm nga ora 06:00 – 22:00; (ii) Kufizimi i lëvizjes së lirë të njerëzve, lejohet vetëm nga ora 06:00 – 22:00. |
| 17 Nëntor 2020 | (i) Ndalimi i tubimeve masive në hapësira të hapura ose të mbyllura; |
| 21 Dhjetor 2020 | (i) Kufizimi i lëvizjes së këmbësorëve, lejohet vetëm nga ora 06:00 – 20:30. Ky urdhër ishte në fuqi nga 24 dhjetor 2020 deri më 4 janar 2021; (ii) Pezullimi i të gjitha fluturimeve ajrore drejt/nga Britania e Madhe nga 22 dhjetori 2020 deri më 6 janar 2021. |
| 11 Janar 2021 | (i) Shqipëria fillon vaksinimin kundër COVID-19 ; |
| 10 Shkurt 2021 | (i) Kufizimi i aktivitetit të bareve, restoranteve, hoteleve, lejohet vetëm nga ora 06:00 – 20:00. Ky urdhër ishte në fuqi nga data 11 deri më 25 shkurt 2021; (ii) Kufizimi i lëvizjes së lirë të njerëzve, lejohet vetëm nga ora 06:00 – 20:00. Ky urdhër ishte në fuqi nga data 11 deri më 25 shkurt 2021. |
| Burimi: Të dhënat janë nxjerrë nga faqja e internetit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Zyrës së Kryeministrit | |

Bibliografia

1. Organizata Botërore e Shëndetësisë, "The different types of COVID-19 vaccines," 12 janar 2021, <https://www.who.int/news-room/feature-stories/detail/the-race-for-a-covid-19-vaccine-explained>.
2. Nga dhjetori 2019 deri në dhjetor 2022, në nivel global ka pasur afërsisht 7 milionë vdekje. Organizata Botërore e Shëndetësisë, "WHO Coronavirus (COVID-19) Dashboard," konsultuar në 18 janar 2023, <https://covid19.who.int/>.
3. Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, "The Impact of the COVID-19 Pandemic on Trade and Development: Lessons Learned," 24 qershor 2022, https://unctad.org/system/files/official-document/osg2022d1_en.pdf.
4. Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, "Albania 2020 Report," Komisioni Europian, 6 tetor 2020, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf.
5. Zyra e Kryeministrit, "Shqipëria buzëqesh: Vaksinimi kundër Covid-19 në proces" 11 janar 2021, <https://www.kryeministria.al/neesroom/konferenca-per-shtyp-e-kryeministrit-edi-rama-pa-ranisjes-se-jetesimit-te-fushates-shqiperia-buzeqesh/>.
6. Coronavirus Shqipëri, "Statistika: Vdekjet nga COVID-19 në Shqipëri gjatë 2020-2022," konsultuar në 6 janar 2023, <https://coronavirus.al/statistika/>.
7. Grupi i Bankës Botërore, "Western Balkans Regular Economic Report No.20: Greening the Recovery," 2021, <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/36402/Greening-the-Recovery.pdf?sequence=1&isAllowed=y>.
8. Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, "Albania Report 2022," Komisioni Europian, 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.
9. Monitor.al, "Shqipëria me vdekshmërinë më të lartë nga Covid-19 në Europë në 2020, rritje rekord," 2021, <https://www.monitor.al/raporti-i-ke-konfirmon-shqiperia-me-vdekshmerine-me-te-larte-nga-COVID-19-e-europe-me-2020-rritje-rekord/>.
10. Sophie Ireland, "Revealed: Countries with The Best Health Care Systems, 2021," *CEO World Magazine*, 27 prill 2021, <https://ceoworld.biz/2021/04/27/revealed-countries-with-the-best-health-care-systems-2021/>.
11. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, "The COVID-19 crisis in Albania," 27 prill 2020, <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania-archive.pdf>.
12. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, "The COVID-19 crisis in Albania," 27 prill 2020, <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Albania-archive.pdf>.
13. Informacion i siguruar nëpërmjet kërkesës së bazuar në të drejtën e informimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 30 janar 2023.
14. *Ibid.*
15. *Ibid.*
16. Vendim i Këshillit të Ministrave, "Mbi procedurat që do të përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesi thelbësor i shtetit," 26 shkurt 2020, https://portavendore.al/wp-content/uploads/2020/03/VKM-nr.203-dt.-26.2.2020-P%C3%ABr-procedurat-q%C3%ABp%C3%ABrdoren-p%C3%ABr-lidhjen-e-kontratave-q%C3%AB-diktohen-nga-interesa-thelb%C3%ABsor%C3%AB-t%C3%AB-shtetit_compressed.pdf.
17. Denis Tahiri, "Tendera sekrete për të fshehur shkeljet?! Ekspertët: Përdoren për të mbuluar aktet korruptive," *Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore*, 26 shkurt 2022, <https://www.acqj.al/tende-ra-sekrete-per-te-fshehur-shkeljet-ekspertet-perdoren-per-te-mbuluar-aktet-korruptive/>.

18. Open Data Albania, "Decay of Health sector, AIS uncovers: 89% of the funds tendered during the pandemic, were awarded without competition," 16 mars 2022, <https://ndiqparate.al/?p=15517&lang=en>.
19. Alfred Zyliftari, Elsa Dautaj, dhe Seth Facey, "The Covid pandemic and the obscurity of government expenses," 8 gusht 2022, *Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore*, <https://www.acqj.al/en/the-covid-pandemic-and-the-obscurity-of-government-expenses/>.
20. Fjori Sinoruka, "Concern in Albania over String of Secretive COVID-19 Tenders," *Balkan Insight*, 7 tetor 2020, <https://balkaninsight.com/2020/10/07/concern-in-albania-over-string-of-secretive-covid-19-tenders/>.
21. Alfred Zyliftari, Elsa Dautaj, dhe Seth Facey, "The Covid pandemic and the obscurity of government expenses," 8 gusht 2022, *Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore*, <https://www.acqj.al/en/the-covid-pandemic-and-the-obscurity-of-government-expenses/>.
22. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Raport për zbatimin e buxhetit vjetor: Situata makroekonomike dhe fiskale gjatë 2021," Maj 2022, https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/b_Raporti-per-zbatimin-e-buxhetit-vjetor-situaten-makroekonomike-dhe-fiskale-gjate-vitit-2021-final.docx.
23. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Vaksinimi antikovid/ 3,029,614 vaksinime, 1 janar 2023, <https://shendetesia.gov.al/vaksinimi-anticovid-3029614-vaksinime/>.
24. Instituti i Shëndetit Publik, "Qëndroni të përditësuar me informacionet më të fundit për vaksinat ndaj covid-19, pyetje dhe përgjigje," maj 2022, <https://www.ishp.gov.al/zgjidh-jeten-vaksinohu/>.
25. Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, "Shqipëria dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë," 24 Dhjetor 2021, <https://www.punetegashtme.gov.al/en/organizata-boteroe-e-shendete-sise-obsh/>.
26. UNICEF, "COVID-19 Market Dashboard," 16 janar 2023, <https://www.unicef.org/supply/covid-19-market-dashboard>
27. Informacion i siguruar nëpërmjet kërkesës për të drejtën e informimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 30 janar 2023. Vaksinat që iu dhuruan Shqipërisë ishin: Pfizer-BioNTech, Vaxzevria-AstraZeneca dhe Gam-COVID-Vac-Sputnik).
28. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, "Public Perceptions towards bilateral relations, cross border cooperation and identity issues in Albania," Mars 2022, http://csdgal-bania.org/wp-content/uploads/2022/04/Final_Barometer-2021-Albania-3-ENG.pdf.
29. Informacion i siguruar nëpërmjet kërkesës për të drejtën e informacionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 30 janar 2023.
30. Zëri i Amerikës, "Mjekët nga Kosova vaksinohen në Shqipëri," 20 mars 2021, <https://www.zeri-amerikes.com/a/mjeket-nga-kosova-vaksinohen-n-shqipëri-20-mars-2021/>.
31. Abcnews.al, "Kosova nuk pranon vaksinat kineze nga Shqipëria, Kurti: Do të marrim vetëm nga shtete që na kanë njohur," 5 prill 2021, <https://abcnews.al/kosova-nuk-pranon-vaksinat-kineze-nga-shqipëria-kurti-do-marrim-vetem-nga-shtete-qe-na-kane-njohur/>.
32. European Union External Action, "Albania – an example of European solidarity against the coronavirus," 31 Mars 2020, https://www.eeas.europa.eu/eeas/albania-%E2%80%93-example-european-solidarity-against-coronavirus_en#:~:text=%E2%80%9CStrong%20and%20coordinated%20action%20is,country%2C%E2%80%9D%20underlined%20Josep%20Borrell.
33. Kuvendi i Shqipërisë, "Ligji Nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive," konsultuar më 21 tetor 2022 <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj-nr.-15-dt.-10.3.2016-1.pdf>.

34. Instituti i Shëndetit Publik, "Komunikimi i përditshëm për koronavirusin," 27 tetor 2020, <https://www.ishp.gov.al/komunikimi-i-perditshem-per-koronavirusin-27-tetor-2020/>.
35. Laylo Merali dhe Ena Bavčić, "Cybersecurity and Human Rights in the Western Balkans: Mapping Governance and Actors," *Qendra e Gjenevës për Sigurinë e Sektorit të Qeverisjes*, shtator 2022, <https://www.dcaf.ch/cybersecurity-and-human-rights-western-balkans-mapping-governance-and-actors>.
36. Inva Hasanaliaj, "Lajmet e rreme që qarkulluan më shumë për Covid-19," *Faktoje*, 2 prill, 2020, <https://faktoje.al/lajmet-e-rreme-qe-qarkulluan-me-shume-per-covid-19/>.
37. Joel Çela, "Lajmet e rreme dhe vaksinimi që ka ngecur në nivel global," *Faktoje*, 8 gusht 2021, <https://faktoje.al/lajmet-e-rreme-dhe-vaksinimi-qe-ka-ngecur-ne-nivel-global/>.
38. Alfred Çako, "Ja çfarë do t'u ndodhë pas një viti atyre që vaksinohen sot ...",
1. *Top Channel*, 2 dhjetor, 2020, https://www.youtube.com/watch?v=GP7f3p80_MQ.
39. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "COVID - 19 Plan Veprimi i Shqipërisë: Parandalimi, përgatitja dhe veprimi kundër COVID-19," mars 2020, https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Covid_AL-spreads.pdf.
40. Kombet e Bashkuara Shqipëri, "A Special Covid-19 Response Newsletter Issue No. 14," janar 2022, https://albania.un.org/sites/default/files/2022-01/UNALB%20Covid%20Response_Issue%2314_1.pdf.
41. Florian Bieber, Tena Prelec, Dejan Jović and Zoran Nechev, "The Suspicious Virus: Conspiracies and COVID19 in the Balkans," *Grupi Këshillimor për Politikën Ballkane në Europë*, korrik 2021, <https://biepag.eu/wp-content/uploads/2021/07/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf>.
42. Leonie Vrugtman dhe Marsela Dauti, "Opinion Poll 2020: Trust in Governance," *Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim*, nëntor 2021, <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2020-EN.pdf>.
43. *Ibid.*
44. Alfred Zylyftari, Elsa Dautaj, dhe Seth Facey, "The Covid pandemic and the obscurity of government expenses," 8 gusht 2022, *Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore*, <https://www.acqj.al/en/the-covid-pandemic-and-the-obscurity-of-government-expenses/>.
45. Arjan Dyrmishi, "Democracy and the state of emergency: Easing Measures and Rising Tensions in the Struggle with the Corona Crisis in Albania," *Friedrich Ebert Stiftung*, 15 qershor 2020, <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/16286.pdf>.
46. Evelina Azizaj, Romario Shehu dhe Iliada Korçari, "The 2020 CSO Sustainability Index for Albania, USAID, shtator 2021, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2020-report.pdf>.
47. *Ibid.*
48. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, "Deklaratë e Organizatave të Shoqërisë Civile: "Për dënimet e propozuara në Kodin Penal për parandalimin e pandemisë Covid-19," 11 prill 2020, <https://ahc.org.al/deklarate-e-perbashket-per-median/>.
49. Evelina Azizaj, Romario Shehu dhe Iliada Korçari, "The 2020 CSO Sustainability Index for Albania, USAID, shtator 2021, <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2020-report.pdf>.
50. Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, "Albania Report 2022," *Komisioni Europian*, 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.

51. Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, "Final report on 2021 Parliamentary elections in Albania," *Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë*, 26 korrik 2021, <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>.
52. Freedom House, "Freedom in Albania in 2019," konsultuar në 23 nëntor 2022, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2019>.
53. Freedom House, "Freedom in Albania in 2019," konsultuar në 23 nëntor 2022, <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2022>.
54. Kombet e Bashkuara Shqipëri, "2021 Progress Report: In-depth results," 13 prill 2022, <https://albania.un.org/sites/default/files/2022/UN%20Albania%20Annual%20Progress%20Report%202021%20-%20In%20depth%20results.pdf>.
55. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, "COVID-19 pandemic: UNDP Albania response," <https://www.undp.org/albania/covid-19-pandemic>.
56. *Ibid.*
57. Directorate-General for Neighborhood and Enlargement Negotiations, "Albania Report 2022," *European Commission*, 12 October 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.
58. *Ibid.*
59. Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit, "Albania Report 2022," *European Commission*, 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en.
60. Komisioni Europian, "Commission implementing regulation (EU) 2020/402: Making the exportation of certain products subject to the production of an export authorization," *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Europian*, 14 mars 2020, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020R0402&from=EN>.
61. Alice Taylor, "Albanian PM: EU's vaccine policy, 'shameful mistake,'" *Euractiv*, 30 gusht 2022, https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/albanian-pm-eus-vaccine-policy-shameful-mistake/.
62. Arjan Dyrmishi, "Public Perceptions towards bilateral relations, cross border cooperation and identity issues in Albania," Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, mars 2022, http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2022/04/Final_Barometer-2021-Albania-3-ENG.pdf.



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim